Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Përgjegjës nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare.

Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË

Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë,

zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATE MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti përgjegjës), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në nenin 42 të Aktit normativ nr.9/2019.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

 _____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019².

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____
 Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

² Autorizoj Autoritetin Përgjegjës të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË
MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI NDËRTIMET CIVILE DHE INDUSTRIALE³

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Përgjegjës _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Operatori ekonomik _____, nuk është subjekt i ndërtimeve civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, të dëmtura nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

Personi/at në cilësinë e aksionarit, oraktu, administratorit dhe ose anëtarët e një organi administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësi i tij aksionar ose ortak duhet të deklarojnë se nuk kanë pasur kompetenca vendimarrëse në një shoqëri, ku ndertimet civile civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolaudura, nga kjo e fundit janë të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore, të përcaktuara në nenin 42/5/ë të Aktit normative nr.9/2019.

.

.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

³ Akti normativ nr.9, date 16.12.2019 "Për përvallimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" neni 42, pika 5 shkronja ë).

<input type="checkbox"/> Punë:		
Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 13

[Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Përgjegjës]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht⁴;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;

c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;

ç. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

d. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojces 10;

e. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.

ë. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të tre viteve të fundit ushtrimorë 2017, 2018, 2019, të paraqitur pranë autoritetit përkatës tatimor, të konfirmuara nga ky autoritet.

b) Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit duhet te mos jete me e vogel se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % fondit limit dhe konkretisht: 3,137,871 (tre milionë e njëqindetridhjeteshtatmijë e tetqindeshtatëdhjetenjë) lekë pa TVSH.

⁴ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e sherbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Të paktën 5 vjet eksperiencë aktive në fushën projektimit – vërtëtohet sipas Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, lëshuar nga QKR

2.3.2 Licenca profesionale e operatorit për realizimin e objekti të kontratës, sipas parashikimeve të VKM Nr. 759/2014, i ndryshuar:

Lidhja 2 “Kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, pika 1 “Projektim Urbanist”, gërma “c”-Plane të detajuara vendore

2.3.3 Ekspertët e stafit kryesor:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për të vërtetuar se kanë pjesë të skuadrës ekspertët e mëposhtëm, duhet të paraqesin për secilin ekspert kontratë pune të vlefshme, ose kontratë/marrëveshje bashkëpunimi, ose listëpagesat shoqërisë për 3 muajt e fundit, si edhe dokumentacionin e kërkuar për secilin ekspert:

Udhëheqësi i Grupit (Planifikues Urban), duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive:

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Planifikim territori/Urbanist.
- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim (ose dokumente të tjera të ngjashme sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme: ekperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
- Eksperienca të mëparshme në projekte të planifikimit të territorit dhe disiplina të ngjashme me të;
- CV, në të cilën të theksohet eksperienca në projekte të ngjashme.

Koordinator Projekti

- Diploma Master Shkencor në një prej fushave të lidhura me planifikimin, si: Planifikim territori, Arkitekt, Urbanist, Ekspert Trashëgimie, Ekonomist, Inxhinier, Jurist.
 - Të paktën 5 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme si koordinator projektesh/ menaxher projektesh. Ekperiencë lokale, eksperiencë rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
 - CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.
- Roli i Koordinatorit të Projektit mund të mbulohet edhe nga një prej anëtarëve të propozuar të Stafit Kryesor.

Planifikues Territori

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Planifikim territori/Urbanist;
- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim territori (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet e planifikimit;
- CV, në të cilën theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Arkitekt/ projektues urban

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Urbanist;
- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim territori (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet e planifikimit;
- CV, në të cilën theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Arkeolog

- Diploma të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë, në profilet Arkeologji / Trashëgimi Kulturorë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të jetë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
- Licencë profesionale individuale/persona juridik sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike;
- Të ketë eksperiencë si autor në të paktën 10 (dhjetë) projekte për veprimtari arkeologjike, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.;
- CV, në të cilën theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Restaurator

- Diploma të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Inxhinieri Ndërtimi / Arkitekturë;
- Licensë profesionale në projektim lëshuar nga Ministria e Kulturës në kategoritë AP/1, AP/2 dhe AP/3.
- Të paktën 10 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme, ekperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
- Eksperiencia të mëparshme në projekte të ngjashme në pasuri të trashëgimisë;
- CV, në të cilën të theksohet eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert GIS

- Diploma Master Shkencor në fusha të lidhura me sistemin GIS;
- Licensë profesionale/ certifikatë mbi përdorimin dhe zotërimin e GIS (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 5 vite eksperiencë të ngjashme në çështje të planifikimit të lidhura me mbledhjen e grumbullimin e të dhënave dhe përditësimin e informacioneve;
- CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një listë me Konsulentët me kohë të pjesshme:

- a. Planifikues Transporti
 - b. Ekonomist urban
 - c. Inxhinier/ ekspert Mjedisor
 - d. Gjeolog dhe Hidrogeolog
 - e. Inxhinier Hidro (rrjeti i furnizimit, kanalizimet dhe impiantet)
 - f. Inxhinier Elektrik
 - g. Ekspert Ligjor
- Kërkesat minimale për Konsulentët:
- Diplomë / Licensë profesionale për secilin konsulent;

- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme;
- CV, në të cilën të theksohen projekte apo përgjegjësi të ngjashme
- Kontrata e punës/kontratë bashkëpunimi

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 14

Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Hartimi i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re të Zhvillimit, zonën e dëmtuar arkeologjike të Durrësit, Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës”.

Afatet e ekzekutimit: 25 ditë pune nga momenti i nënshkrimit të Kontratës

Shtojca 16

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës)

TERMAT E REFERENCËS⁵

SHËRBIM KONSULENCE PËR HARTIMIN E
PLANEVE TË DETYRUARA VENDORE (PDyV)
PËR ZONAT E REJA TË ZHVILLIMIT,
ZONA 5, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, BASHKIA DURRËS

⁵ Ju këshillojmë të lexoni me kujdes dhe në mënyrë analitike Termat për të krijuar një bazë të mirë pune për hartimin e propozimeve garuese dhe për hartimin e PDy-së më pas. Në çdo rast jeni përgjegjës për t'u njohur me legjislacionin e planifikimit dhe zhvillimit në fuqi dhe të hartoni propozime në përputhje me legjislacionin.

PËRMBAJTJA

1.	Sfondi i Ushtrimit	44
1.1.	Hyrje	44
2.	Përshkrimi i Projektit	44
2.1.	Objektivat dhe Informacion mbi Zonat në Studim	44
2.2.	Ndikimi i Pritshëm	51
2.3.	Kadri i Zbatimit	51
2.4.	Përmbajtja e Propozimit Teknik	52
3.	Qëllimi dhe Fazimi i Punës	53
4.	Dokumentet dhe Dorëzimet e Shërbimit të Konsulencës	54
4.1.	Dokumentet	54
4.2.	Dorëzimet	54
5.	Profilet e ekspertëve, Kushtet dhe Detyrimet	55
5.1.	Stafi	55
6.	Baza Ligjore Referuese për Planifikimin e Territorit	57
7.	Shtojcë: Zona Arkeologjike “A” dhe “B” e qytetit të Durrësit	61

Sfondi i Ushtrimit

Hyrje

Në datën 26 nëntor 2019, në orën 03:54 CET (UTC +1), Shqipëria veriperëndimore u godit nga një tërmet i fortë me magnitudë 6.4 me një epiqendër 16 kilometra në perëndim-jugperëndim të Mamurrasit. Dridhja u ndje në Tiranë, si dhe në vende me largësi rreth 370 kilometra në verilindje të epiqendrës. Tërmeti shënoi viktima dhe shumë të plagosur. Dëmet materiale ishin të tepërta. Shumë nga vendbanimet kryesore të Shqipërisë së mbi-Shkumbinit u 'dërrmuan' nga tërmeti; banesa e objekte u shembën, ose u bënë të pabanueshme, duke shkaktuar ndikim shoqëror të konsiderueshëm. Dëme më të shumta u shënuan në qytetin e Durrësit dhe fshatin e Kodër-Thumanës, të cilat ndodhen afër epiqendrës së tërmetit. Dy hotele dhe dy pallate u shembën në Durrës. Katër ndërtesa, përfshirë një pallat 5-katësh u shembën në Kodër-Thumanë. Edhe qyteti i Laçit u dëmtua gjerësisht; nuk kishte objekte të shembura gjatë goditjes së tërmetit, por një numër banesash u bënë të banueshme, si pasojë e goditjes.

Për nga shkalla e magnitudës ky ishte tërmeti më i madh që ka goditur Shqipërinë në më shumë se dyzet vjet.

Përshkrimi i Projektit

Objektivat dhe Informacion mbi Zonat në Studim

Menjëherë, pas përfundimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit, filloi puna për rindërtimin dhe rehabilitimin fizik e social të zonave të dëmtuara nga tërmeti. U miratua Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", i cili ka ngritur kornizën e procesit të rindërtimit dhe mëkëmbjes sociale. Mes të tjerash, Akti Normativ, parashikon paraprirjen e procesit të rindërtimit nga planifikimi i territorit. Për t'iu përgjigjur nevojës së momentit për shpejtësi veprimi dhe marrjen e masave të menjëhershme, Akti Normativ ka parashikuar një dokument të ri planifikimi, të posaçëm për raste të emergjencave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore. Ky instrument është Plani i Detyruar Vendor (PDyV), i cili ngjason me Planin e Detajuar Vendor (PDV), por ka edhe disa veçanti që i përgjigjen specifikave të rastit. PDV hartohet për Njësi Strukturore të përcaktuara nga Dokumenti i Planit të Përgjithshëm Vendor. Ndërsa, PDyV hartohet për një zonë të veçantë, të shpallur me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, si Zonë e Re për Zhvillim (ZRZh), e cila mund të jetë një zonë e dëmtuar, ose një territor i lirë nga ndërtimet, apo i përshtatshëm për procesin e rindërtimit.

“Zonë e re për zhvillim”, është territori që përcaktohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

“Zonë e dëmtuar”, është territori që përfshin një ose disa ndërtesa, infrastruktura publike apo edhe infrastrukturë kritike të dëmtuar. “Plan i detyruar vendor”, është dokument planifikimi që hartojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse, sipas rastit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe, kur çmohet e nevojshme, për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit, që përcakton kushtet për zhvillim të detyruar, si dhe zhvillimin e zonave të reja.

“Zhvillim i detyruar”, e drejta e autoritetit përgjegjës për të vendosur prishjen e ndërtesave dhe zhvillimin e territorit ku ndodhen ndërtesa apo një grup ndërtesash, në pronësi publike apo private, si rezultat i dëmtimit të tyre nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe që rrezikon jetën e shëndetin e banorëve, si dhe për zhvillimin e zonës së re në përputhje me planin e detyruar vendor, sipas parashikimeve aktit.

Zona e Re për Zhvillim propozohet nga Bashkitë për miratim në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit (KSHR) dhe më pas shpallet me Vendim të Këshillit të Ministrave. KSHR, miraton ZRZh, por edhe programin që do të zhvillohet në zonë. Vendimi i KSHR është bazë për hartimin e Temrave të Punës (ToRs) për hartimin e PDyV-së. Programi i propozuar në KSHR, zakonisht përmban si fillim kapacitetin e familjeve që priten të akomodohen në ZRZh, të grupuara sipas tipologjisë së familjes, 1-2 anëtarë; 3-4 anëtarë; 4+ anëtarë. Programi shoqërohet sipas rastit edhe me parashikime për objekte/ shërbime publike dhe infrastrukturë publike/ kritike.

Këshilli i Ministrave, në zbatim të Aktit Normativ 9/2019, ka miratuar VKM nr. 887, datë 24.12.2019, "Për caktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore". Këtu përcaktohen rregullat kryesore për hartimin dhe miratimin e PDyV-së

PROCEDURA E PËRSHEPTUAR PËR HARTIMIN DHE MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR.

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore identifikojnë zonat të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të planit të detyruar vendor, me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
2. Plani i detyruar vendor hartohet me nismë publike në zona të cilat janë:
 - a. një, apo disa njësi strukturore bashkë, në pronësi publike apo private, të dëmtuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore;
 - b. një, apo disa njësi strukturore bashkë, në pronësi publike apo private të miratuara si zonë e re për zhvillim, me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Plani i detyruar vendor ka për qëllim:
 - a. zhvillimin dhe/ose rrizhvillimin e një zone të dëmtuar nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore;
 - b. zhvillimin e një zonë të re për të përballuar nevojën për strehim të familjeve të prekura nga fatkeqësia;
 - c. ndërtimin e infrastrukturave publike.
4. Plani i detyruar vendor, përmban të paktën:
 - a. planin e përcaktimeve territoriale, i shprehur në relacion dhe harta shoqëruese për pikat e mëposhtme:
 - i. analizën që paraprin përcaktimet territoriale;
 - ii. përcaktimet për përdorimin e tokës për çdo nënnjësi në nënkategori dhe funksione sipas rregullave të VKM 686/2017, e ndryshuar;
 - iii. përcaktimet e infrastrukturave teknike, duke përfshirë ato të transportit, energjisë, telekomunikacionit dhe ujësjellës-kanalizimeve;
 - iv. përcaktimet e kushteve të zhvillimit për nënnjësitë dhe/ose për parcelat;
 - v. programin për zbatimin e planit të detyruar vendor – ndërtimin e infrastrukturave, shërbimeve publike dhe banesave;
 - b. rregulloren e planit të detyruar vendor, mbështetur në përcaktimet për rregulloren e PDV-së, sipas VKM 686/2017, e ndryshuar;
 - c. imazhe ilustruese për zhvillimin e zonës;
 - d. raportin e vlerësimit teknik që paraprin miratimin e planit.
5. Grupi i punës, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë dhe i përbërë nga specialistë të bashkisë dhe/ose ekspertë të licencuar të përzgjedhur sipas parashikimeve të Aktit Normativ n.9/2019, harton planin e detyruar vendor brenda 30 ditëve punë nga data e shpalljes me vendim të Këshillit të Ministrave të zonës së re për zhvillim dhe/ose nga data e identifikimit të zonës të dëmtuar nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore që përfshihet në zhvillim dhe ia paraqet Kryetarit të Bashkisë për miratim.

6. KKTKM miraton planin e detyruar vendor, bazuar në raportin e vlerësimit teknik, të përgatitur nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, në bashkëpunim.
7. Kryetari i Bashkisë vendosin miratimin e planit të detyruar vendor, pas miratimit të KKTKM-së, brenda 5 ditëve punë nga dorëzimi për miratim i dokumentacionit të plotë të planit nga ana e strukturës përgjegjëse të planifikimit të autoritetit vendor.
8. Plani i detyruar vendor, përfshirë edhe Nismën për hartimin e planit, botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, brenda 15 ditëve nga miratimi, si edhe regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme si bazë për kryerjen e transaksioneve me pronën.
9. Plani i detyruar vendor dërgohet dhe paraqitet për njohje edhe në Këshillin Kombëtar të Territorit, në mbledhjen e radhës.
10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa që pas miratimit, plani i detyruar vendor të integrohet me planin e përgjithshëm vendor, duke ndjekur përcaktimet e VKM-së 686/2017, e ndryshuar.

Qeveria shqiptare ka caktuar, nga Fondi i Rindërtimit, një fond të posaçëm për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe ka ngarkuar Agjencinë e Planifikimit të Territorit dhe Bashkinë Tiranë si njësi zbatuese për hartimin e PDyV-ve, mbi bazën e VKM nr.9, datë 10.01.2020, "Për caktimin e njësive zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga Fondi për Rindërtimin miratuar në Buxhetin e vitit 2020".

Ky projekt është ndërtuar për hartimin e PDyV-ve në 10 Bashki të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor: Lezhë, Mirditë, Kurbin, Krujë, Kamëz, Tiranë, Vorë, Shijak, Durrës dhe Kavajë. Secila nga këto bashki parashikohet të propozojë nga 1-5 ZRZh, për të cilat duhet të hartohen PDyV, sipas përcaktimeve të 'legjislacionit të rindërtimit'.

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, më datë 18 Maj, të vitit 2020, miratoi propozimin për caktimin e zonës së dëmtuar arkeologjike të Durrësit si Zonë e Re për Zhvillim, në kuadër të përcaktimeve të Aktit Normativ 9/2019. Zona u shpall më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave, si ZRZh.

Zona e shpallur është:

1. Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, për:
 - a) rindërtimin e banesave të dëmtuara, mbi bazën e akt ekspertizave të thelluara të IN;
 - b) rehabilitimin mjedisor të zonës së dëmtuar arkeologjike të Durrësit;

Objekti i shërbimit të konsulencës është:

- Hartimi i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Re të Zhvillimit, zonën e dëmtuar arkeologjike të Durrësit, Zona 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës.

Informacion për ZRZh 5 Durrës, Durrës

Sipërfaqe totale e Zonës 5 është 53, 1 ha.




Figura 1: Zonë e Re për Zhvillim, zona 5, Durrës; koordinatat e zonës

Kufiri i zonës përfshin një ndër hapësirat më të rëndësishme arkeologjike, arkitektonike dhe historike të qytetit të Durrësit, e cila pësoi dëmtime të konsiderueshme nga tërmeti. Siti i propozuar për rehabilitim ndodhet brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, shpallur me Vendim Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”. Gjithashtu brenda kësaj zone ndodhen disa nga pasuritë kulturore më të rëndësishme kombëtare, si Parku Arkeologjik i Durrësit me Amfiteatrin, Muret e Kalasë, Termat Antike dhe Rotundën, si dhe monumente të kategorisë së parë si Hamami, Xhamia e Fatihut, Pusi i Tophanës, Ndërtesa me Moziak, e disa banesa të rëndësishme si ajo e Fan Nolit, Aleksandër Moisiut dhe e familjes Manushi e Pali.

Propozimi për hartimin e një plani të detyruar dhe detajuar për zonën, ka si qëllim përfundimin e një plani të qendrueshëm për bashkëjetesën harmonike mes trashëgimisë unike të Durrësit dhe vendbanimit në të, si një domosdoshmëri jetike. Rindërtimi i objekteve të banimit të dëmtuara nga tërmeti, rikualifikimi i dëmeve që kanë pësuar elementë të trashëgimisë kulturore materiale, mbrojtja e tyre nga dëmtime të mundshme në të ardhmen dhe gjithashtu rehabilitimi i hapësirës përreth elementëve të trashëgimisë dhe në mënyrë të posaçme përreth Amfiteatrit të Durrësit dhe përcaktimi

i kufirit të zonës për rijetëzim, vlerësimi i impaktit ekonomik dhe social të pritshëm, akomodimi brenda zonës të familjeve që mund të zhvendosen për shkak të rijetëzimit, janë objektivat kryesorë që kërkohen të arrihen nëpërmjet hartimit të Planit.

Ky propozim synon jo vetëm strehimin e përshtatshëm dhe afatgjatë të të dëmtuarve të zonës nga tërmeti, por edhe gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme në trajtimin e banesave të ndodhura në afërsi të Parkut Arkeologjik të qytetit të Durrësit, të cilat në gjendjen dhe formën aktuale përbëjnë një rrezik të vazhdueshëm për njëri-tjetrin. Hartimi i PDyV-së do ndihmojë gjithashtu edhe hartimin e Planit të Menaxhimit të zonës Arkeologjike Durrës A dhe B, i cili do të ketë në fokus integrimin më të mirë mes trashëgimisë dhe aktivitetit njerëzor. Njëkohësisht mbrojtja e të gjithë vlerave që paraqet kjo zonë dhe promovimi i tyre do t'i kthejë ato në vlera me përfitime ekonomike sidomos për komunitetin lokal, ashtu si ndodh në të gjitha qytetet europiane apo edhe të largëta me pasuri kulturore të ngjashme, të cilat janë kthyer në motorin ekonomik të tyre. Rikualifikimi urban i zonës pritet të ketë një impakt social dhe ekonomik të konsiderueshëm për qytetin e Durrësit.

Rëndësia e zonës së propozuar

Brenda zonës së propozuar të PDyV-së ndodhen disa prej monumenteve më të rëndësishme kombëtare, me vlera të patjetërsueshme si:

- Parku Arkeologjik i Durrësit me elementët:
 - Amfiteatri i Durrësit
 - Kalaja Durrës
 - Termat Antike
 - Rotunda
- Monumente të kategorisë së parë dhe të dytë:
 - Hamami në oborrin e Shkollës “16 Shtatori” - *monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.*
 - Xhamia e Fatihut - *monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.*
 - Pusi i Tophanës - *shpallur monument kulture kategoria e I-rë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.*
 - Rrënojat e Ndërtesës me Mozaik - *monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Kulturës Nr. 283, datë 23.07.2015.*
 - Banesa e Fan Nolit - *monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Vendim Nr. 4, datë 07.05.1991 të Komitetit të Kulturës dhe Arteve Drejtoria e Muzeumeve dhe Arteve.*
 - Banesa “Aleksandër Moisiu” – Muzeu Etnografik, Durrës - *monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.*
 - Banesa e familjes Manushi dhe Pali (Banesa Nr. 115) - *monument kulture kategoria e I-rë me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 308, datë 21.05.2006.*
 - Banka Kombëtare Tregtare - *monument kulture kategoria e II-të, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr.197, date 30.03.2018.*



Figure 2: Evidentimi i monumenteve brenda kufirit të PDyV-së së propozuar

Grupet e inspektimit kanë vlerësuar shkallën e dëmit të monumenteve si rrjedhojë e tërmetit. Në bazë të inspektimit të tyre, objekti i Amfiteatrit në vetvete rezulton se ka dëmtime të cilat kanë nevojë për vëmendje të veçantë restauruese, por dëmtimet më të mëdha dhe ato më shqetësueset vlerësohet se i janë shkaktuar nga ndërhyrjet e jashtme, si pasojë e goditjeve dhe ndikimit nga ndërtimet e pozicionuara mbi monument dhe në afërsi të tij.

Nga ana tjetër, grupet e vlerësimit të Bashkisë dhe Institutit të Ndërtimit, së bashku me ekspertët e huaj të angazhuar gjatë muajit nëntor, dhjetor e janar kanë vlerësuar shkallën e dëmit të banesave mbi amfiteatër dhe në rrethinat e tij, të cilat i ka dëmtuar jo vetëm goditja e dy tërmete të vitit 2019, por edhe koha dhe amortizimi që ndodh natyrshëm prej viteve dhe mungesës së mirëmbajtjes së posaçme. Puna nga specialistët e Institutit të Ndërtimit për vlerësimin e thelluar të dëmit për banesat në Durrës në tërësi, dhe në veçanti për ato që gjenden në perimetrin e ndikimit të Amfiteatrit, vijon, në kushtet kur një sasi e konsiderueshme prej tyre janë deklaruar të pabanueshme.

Nga diskutimet e derimësotme të specialistëve të trashëgimisë dhe atyre të ndërtimit, vlerësohet se bashkëjetesa aktuale e objekteve të banimit mbi monument, pas dëmeve të shkaktuara si nga koha ashtu dhe nga tërmetet, përbën rrezik të dyfishtë si për vetë objektet e banimit ashtu edhe për monumentin.

Nga ekspertët vlerësohet se rindërtimi i objekteve të banimit të dëmtuara, duhet të bëhet në një perimetër që nuk krijon mbivendosje me monumentin e Amfiteatrit dhe që krijon siguri në vazhdimësi për funksionin e banimit dhe nga ana tjetër për ruajtjen e Amfiteatrit.



Figure 3: Parcelat e pronësisë në afërsi të Amfiteatrit

Nisur nga shtjellimet dhe argumentet e mësipërme, dhe nga rëndësia që paraqet Amfiteatrit si pasuri kombëtare, specialistët e trashëgimisë dhe ata të ndërtimit propozojnë që territori mbi amfiteatër dhe në afërsi të tij, të rehabilitohet me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e pasurisë dhe të vlerave që monumenti prezanton. Rindërtimi i banimit të sigurohet brenda zonës së PDyV-së, në përputhje me Legjislacionin e Rindërtimit dhe atë të Trashëgimisë Kulturore në përgjithësi dhe Planin për “Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit” në veçanti. Detajet për rindërtimin dhe rehabilitimin duhet të jepen nga PDyV-ja e zonës së propozuar.

Ndikimi i Pritshëm

Pritet që Plani i Detyruar Vendor të drejtojë procesin e rimëkëmbjes së komuniteteve të dëmtuara nga tërmeti. PDyV do të parashikojë masa për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale në të ardhmen, **në raste të ngjashme në zonën e dëmtuar të trashëgimisë në Durrës.**

PDyV duhet të përmbushë, për aq sa të jetë e mundur, përcaktimet e Kreut II, të Aktit Normativ nr. 9/2019, lidhur me parimet e përgjithshme.

Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka si qëllim, për aq sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese dhe funksionimi të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen.

Autoritetet publike dhe (projektuesit) përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve dhe teknikave që parandalojnë rreziqet e fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me konceptin “rindërto më mirë”.

(Projektuesit, përgjatë procesit të planifikimit dhe projektimit), të marrin në konsideratë që përballimi i pasojave të fatkeqësisë natyrore të plotësojë, për aq sa është e mundur, jo vetëm nevojat e qytetarëve për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të shëndetit, por njëkohësisht të mos ndikojë në aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

Strehimi i përshtatshëm për një individ ose familje konsiderohet strehimi që garanton privatësi, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.

Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi;

b) Shërbimet bazë, brenda mjedisit të banimit;

c) Qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;

ç) Qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;

d) Akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare.

Kuadri i Zbatimit

Konsulenti thirret, nëpërmjet këtij projekti, për të asistuar Bashkinë dhe Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), në përmbushjen e detyrimeve ligjore të hartimit të Planeve të Detyruara Vendore, të cilat kanë për qëllim orientimet e zhvillimit të territorit në funksion të rimëkëmbjes post-tërmet. Ndaj, konsulenti do të punojë ngushtësisht me stafin e Bashkisë dhe AKPT-së përgjatë gjithë kohëzgjatjes së shërbimit. Në mbështetje, nga AKPT-ja, do të caktohet staf i dedikuar në bashkëpunim me IKTK-në dhe Ministrinë e Kulturës, për të koordinuar procesin e planifikimit.

AKPT-ja do të jetë përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin e procesit, koordinimin dhe bashkërendimin e tij, sikurse edhe të produkteve që do të dalin prej tij dhe do të mbështesë të gjitha palët e përfshira në proces për t'u njohur dhe familjarizuar me detyrimet ligjore që rrjedhin për hartimin e planeve të detyruara vendore për zonat e reja të zhvillimit.

Planet e Detyruara Vendore për Zonat e Reja të Zhvillimit, sipas Aktit Normativ 9/2019, hartohen me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe, kur çmohet e nevojshme, për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit, që përcakton kushtet për zhvillim të detyruar, si dhe zhvillimin e zonave të reja.

Periodha për draftimin e planit do të shtrihet në 25 ditë (pune) dhe do të ndahet në faza për efekt të organizimit të procesit të punës, sipas përcaktimeve të VKM 887/2019. Ndarja në faza e punës për hartimin e planit bëhet për një konsultim dhe koordinim më të mirë të procesit, i cili do të përfshijë kryesisht pjesëmarrjen e tre institucioneve publike: Bashkisë, Institutit të Monumentve të Kulturës dhe AKPT-së.

Fazat e hartimit të PDyV-ve:

- Faza 1: Analiza dhe Plani i Përcaktimeve (Strategjia) Territoriale (parashikohet, 7 ditë);
- Faza 2: Plani i Zhvillimit dhe Rregullorja paraprake e Planit (parashikohet, 10 ditë);
- Faza 3: Plani i Detajuar i Zhvillimit, Rregullorja e detajuar e Planit (parashikohen, në 8 ditë).

Në pikëpamje të kohës dhe kohëzgjatjes, fazat mund të mbivendosen me njëra-tjetrën – kjo nënkupton se puna për fazat e mëvonshme mund të fillojë në një fazë më të hershme, dhe puna për fazat e para mund të vazhdojë të përditësohet gjatë fazës më të vonë.

Në propozimin e tyre në përgjigje të këtij projekti, kompanitë konsulente ofertuese, mund të ndryshojnë shtrirjen kohore të secilës fazë, por nuk mund të kalojnë afatin prej 25 ditë, brenda të cilit duhet të dorëzohet produkti i plotë i planit.

Gjatë kohëzgjatjes së draftimit të PDyV-së, konsulenti do të duhet të përmbushë disa detyrime, përveç atyre që lidhen ngushtësisht me draftimin e planit. Konsulenti:

- Do të punojë ngushtësisht dhe do të zhvillojë takime periodike me stafin e Bashkisë dhe AKPT-së dedikuar procesit të planifikimit;
- Do të mbajë AKPT-në të informuar rreth progresit dhe çdo çështje a problematike të hasur, nëpërmjet Udhëheqësit të grupit ose Koordinatorit të Projektit;
- Do të aplikojë një metodologji të integruar pune. Të gjithë grupet e interesit duhet të përfshihen për të kontribuar sipas mënyrës së tyre në zhvillimin e ardhshëm të zonës;
- Do t'i përgjigjet kërkesave të Bashkisë, Institucioneve publike, grupeve të interesit, etj., për informim të hollësishëm mbi procesin dhe produktet e tij;
- Do t'i përgjigjet kërkesave të argumentuara të Bashkisë, AKPT-së, IKTK-së dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në proces për ndryshime e përmirësim të dokumentit të planit.

Përmbajtja e Propozimit Teknik

Propozimi teknik do të analizojë detyrat e Termave të Referencës për këtë projekt.

Propozimi Teknik do të japë informacionin e diktuar në paragrafët e mëposhtëm, nga (a) deri në (e).

- a) Kërkohet një përshkrim i shkurtër i organizimit të konsulentit dhe një listim i eksperiencave të punës së tij në projekte të ngjashme në fushën e arkeologjisë, konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë, zhvilluar kohëve të fundit, apo në rastin e bashkimit të konsulentëve, listim të punëve të secilit prej partnerëve;
- b) Komente dhe sugjerime rreth Termave të Referencës, ku të përfshihen sugjerime që mund të përmirësojnë cilësinë dhe eficiencën e projektit; sikurse edhe rreth stafit dhe faciliteteve të punës, ku përfshihen mbështetja administrative, baza e të dhënave, etj., të cilat duhet të ofrohen nga autoriteti përgjegjës për planin;
- c) Një përshkrim i detajuar i përjasjes, metodologjisë, vizionit dhe planit të punës;

- d) Plani i punës duhet të jetë në përputhje me Skedulën e Punës, e cila duhet të tregojë në formën e një grafiku linear kohën e planifikuar për çdo aktivitet, sikurse edhe personat/stafin përgjegjës për implementimin e aktivitetit;
- e) Lista e stafit profesional të propozuar sipas fushës së ekspertizës, pozicionit të caktuar për secilin anëtar të stafit si edhe detyrat respektive në përputhje me Termat e Referencës;

Propozimi Teknik nuk duhet të përmbajë të dhëna financiare. Një Propozim Teknik me informacion financiar do të deklarohet jo i përgjegjshëm.

Qëllimi dhe Fazimi i Punës

Qëllimi i punës konsiston në:

- Hartimin e Planit të Detyruar Vendor të Zonës së Re për Zhvillim, 5, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm të rindërtimit (Akt Normativ 9/2019, VKM 887/2019), atij të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për aq sa nuk bie ndesh me të parin, si dhe të Termave të Referencës.
 - o Plani duhet të jetë ‘tailor made’ për zonën e caktuar;
 - o Ai duhet të jetë i thjeshtë për t’u përdorur nga të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e zhvillimit të territorit dhe i qartë;
 - o Plani duhet të jetë i bashkërenduar dhe i konsultuar, por sidomos i pranuar nga aktorët e përfshirë në proces (Bashkia, AKPT, IKTK, komuniteti i prekur nga tërmeti);
- Ndërtimin e një procesi pune që do t’i sjellë përfitime në disa drejtime sektorit të rindërtimit, duke nisur nga njohja e territorit dhe bashkërendimi i aktorëve me ndikim në të e deri në rritjen e kapaciteteve të institucioneve të përfshira në drejtim të orientimit të zhvillimit nëpërmjet planeve të territorit.

Procesi i hartimit të PDyV-ve, i ndarë në disa faza, përfshin përmbushjen e disa detyrimeve që përkojnë me legjislacionin përkatës. Secila prej fazave do të përmbyllet me dorëzimin e një ose më shumë raporteve teknike shoqëruar me materialin grafik/hartografik përkatës.

Para fillimit zyrtar të punës për hartimin e PDyV-së, Bashkia, IKTK dhe AKPT do të vendosin në dispozicion të grupit të punës inventarin e të gjithë zonës, si edhe një listë të detajuar të çështjeve që duhet të adresohen nga Plani, brenda kornizës së këtyre Termave.

Dokumentet dhe Dorëzimet e Shërbimit të Konsulencës

Dokumentet

Konsulenti do të përgatisë dokumentet e mëposhtme:

1. Dokumentat e Fazës I për PDyV-në – 1 raport dhe harta/t.

Dorëzimi Draft: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs.

Dorëzimi Përfundimtar: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs si edhe rezultatet e këshillimeve.

2. Dokumentat e Fazës II për PDyV-në - 1 raport dhe harta/t.

Dorëzimi Draft: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs.

Dorëzimi Përfundimtar: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs si edhe rezultatet e këshillimeve.

3. Dokumentat e Fazës III për PDyV-në – 1 raport, hartat dhe databazën territoriale në format GIS.

Dorëzimi Draft: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs.

Dorëzimi Përfundimtar: duhet të ketë në përmbajtje kërkesat e ToRs si edhe rezultatet e këshillimeve.

Dorëzimet

Të gjitha dorëzimet do të kryhen në format e mëposhtme:

- Dorëzim në format elektronik (PDF, GIS) në Bashki dhe AKPT, për çdo fazë (e-mail, ose CD);
- Botim në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) në bashkëpunim me AKPT (plani i miratuar).
- Dorëzim final hard-copy në AKPT;

Raportet finale do të dorëzohen nga konsulenti për miratim final, në 2 kopje të printuara (1 kopje për Bashkinë dhe 1 kopje për AKPT-në), sikurse edhe në format elektronik (PDF, GIS).

Pas miratimit të dokumentit të planit nga KKTKM-ja dhe Bashkia, konsulenti do të dorëzojë në 3 kopje të printuara, sikurse edhe në format elektronik, materialin e miratuar (për zbardhje).

Të gjitha dokumentet përbërëse të PDyV-së duhet të dorëzohen në gjuhën Shqipe.

Profilat e ekspertëve, Kushtet dhe Detyrimet

Stafi

Konsulenti do të propozojë ekspertët në disiplinat që ai gjykon të nevojshme në mënyrë që të mbulohet i gjithë qëllimi i punës i përshkruar sipas këtyre Termave të Referencës dhe të përgatiten kërkesat e paraqitura.

Konsulenti duhet të sigurohet që ekspertiza me kualifikimin e duhur, të identifikohet dhe t'i përshtatet kërkesave për secilën nga detyrat e listuara mësipër. Nisur nga dimensionimi dhe kompleksiteti i punës për t'u realizuar, grupi i ekspertëve duhet të ketë karakter shumë-disiplinor dhe ku përfshihen profesionistë të cilët do të:

- Adresojnë çështjet më emergjente nga një pikëpamje shumë-disiplinore;
- Ofrojnë njohje të thellë të territorit shqiptar, sfidave dhe potencialeve të tij;
- Integrojnë apo adaptojnë eksperiencën e tyre në projekte të ngjashme në rajone të tjera.

Ekipi i Konsulentit do të punojë me stafin e Bashkisë dhe AKPT-së për të përgatitur PDyV-të, ndaj ata duhet të ndërtojnë një marrëdhënie konstruktive, si dhe një transferim efektiv të njohurive dhe kompetencave.

Ekipi i Konsulentit dhe Grupi i punës do të raportojë në mënyrë të vazhdueshme dhe minimalisht çdo javë, pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, mbi ecurinë e procesit të hartimit të PDyV-së.

Grupi i ekspertëve do të jetë i përbërë nga stafi kryesor, stafi mbështetës dhe konsulentët.

Me 'staf kryesor' do të kuptohet stafi teknik dhe menaxhues, i cili është thelbësor në këtë detyrë. Stafi kryesor duhet të identifikohet qartësisht si 'staf kryesor' dhe po ashtu konsulentët duhet të identifikohen qartësisht si të tillë.

Stafi mbështetës nuk do të vlerësohet, por Ofertuesi duhet të garantojë formimin e këtij grupi duke plotësuar kriteret.

Ekipi i Ofertuesit, duhet të jetë i përbërë nga:

- a. Udhëheqësi i Grupit – staf kryesor
- b. Ekspert me kohë të plotë: koordinator i projektit, eksperti planifikues territori – staf kryesor;
- c. Ekspert/anëtar me kohë të pjesshme – staf kryesor dhe mbështetës;
- d. Konsulent me kohë të pjesshme;

Staf/anëtar me kohë të plotë:

- a. Planifikues territori
- b. Arkitekt/ projektues urban
- c. Projektues Restaurator
- d. Arkeolog
- e. Ekspert GIS

Konsulentët me kohë të pjesshme:

- a. Planifikues Transporti
- b. Ekonomist urban
- c. Inxhinier/ ekspert Mjedisor
- d. Gjeolog dhe Hidrogeolog
- e. Inxhinier Hidro (rrjeti i furnizimit, kanalizimet dhe impiantet)
- f. Inxhinier Elektrik

g. Ekspert Ligjor

Një listë të stafit kryesor, shoqëruar me:

- Diplomat;
- CV-të e tyre (Europass format);
- licencat profesionale (për profesionet që kanë të tilla);
- marrëveshjet e bashkëpunimit, kontratat përkatëse të punës, ose të nënkonsulencës në rast se ky staf nuk është pjesë e shoqërisë;
- në rast të angazhimit të stafit të huaj, ata gjithashtu duhet të jenë të pajisur me një Licensë/Certifikatë ekuivalente në shtetin e tyre të origjinës për kryerjen e shërbimeve objekt të kësaj kontrate dhe të paraqesin CV-të e tyre.

Ekspertët e stafit kryesor duhet të ushtrojnë detyrat si në vijim:

Udhëheqësi i Grupit (Planifikues Urban), duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive:

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Planifikim territori/Urbanist.
- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim (ose dokumente të tjera të ngjashme sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme: eksperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
- Eksperienca të mëparshme në projekte të planifikimit të territorit dhe disiplina të ngjashme me të;
- CV, në të cilën të theksohet eksperienca në projekte të ngjashme.

Koordinator Projekti

- Diploma Master Shkencor në një prej fushave të lidhura me planifikimin, si: Planifikim territori, Arkitekt, Urbanist, Ekspert Trashëgimie, Ekonomist, Inxhinier, Jurist.
- Të paktën 5 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme si koordinator projektesh/ menaxher projektesh. Ekperiencë lokale, eksperiencë rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
- CV, në të cilën të theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme. Roli i Koordinatorit të Projektit mund të mbulohet edhe nga një prej anëtarëve të propozuar të Stafit Kryesor.

Planifikues Territori

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Planifikim territori/Urbanist;
- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim territori (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet e planifikimit;
- CV, në të cilën theksohen eksperienca në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Arkitekt/ projektues urban

- Diploma Master Shkencor në Arkitekturë / Urbanist;

- Licensë profesionale / certifikatë në planifikim territori (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme në çështjet e planifikimit;
- CV, në të cilën theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Arkeolog

- Diploma të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë, në profilet Arkeologji / Trashëgimi Kulturorë të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të jetë njehsuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;
- Licencë profesionale individuale/persona juridik sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Kulturës për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike;
- Të ketë eksperiencë si autor në të paktën 10 (dhjetë) projekte për veprimtari arkeologjike, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.;
- CV, në të cilën theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Restaurator

- Diploma të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilet Inxhinieri Ndërtimi / Arkitekturë;
- Licensë profesionale në projektim lëshuar nga Ministria e Kulturës në kategoritë AP/1, AP/2 dhe AP/3.
- Të paktën 10 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme, eksperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;
- Eksperiencia të mëparshme në projekte të ngjashme në pasuri të trashëgimisë;
- CV, në të cilën të theksohet eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Ekspert GIS

- Diploma Master Shkencor në fusha të lidhura me sistemin GIS;
- Licensë profesionale/ certifikatë mbi përdorimin dhe zotërimin e GIS (ose dokumente të ngjashme dëshmuese sipas vendit të origjinës);
- Të paktën 5 vite eksperiencë të ngjashme në çështje të planifikimit të lidhura me mbledhjen e grumbullimin e të dhënave dhe përditësimin e informacioneve;
- CV, në të cilën të theksohen eksperiencia në projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Një listë të Konsulentëve

Kërkesat minimale për Konsulentët:

- Diplomë / Licensë profesionale;
- Të paktën 10 vite eksperiencë të ngjashme;
- CV, në të cilën të theksohen projekte apo përgjegjësi të ngjashme.

Baza Ligjore Referuese për Planifikimin e Territorit

LEGJISLACIONI NË PROJEKTIM, PLANIFIKIM, ZHVILLIM

- Ligj Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.
- VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” e ndryshuar;
- VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar
- VKM Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”.
- VKM nr.399, datë 13.05.2020 “Për përcaktimin e kufijve të Parkut Arkeologjik Durrës”
- VKM Nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”;
- Ligji Nr. 116/2016 “Për Përformancën e Energjisë së Ndërtesave”;
- Ligj Nr. 8378, date 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- VKM Nr. 153 datë 07.04.2000 “Për miratimin e Rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”;
- VKM Nr. 628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve”;
- VKM nr. 530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”;
- VKM Nr. 626, datë 15.7.2015 “Për miratimin e normativave të projektimit të banesave”;
- VKM Nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit” ndryshuar;
- VKM Nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”;
- VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”;
- VKM Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”
- VKM Nr. 9, datë 10.1.2020 “Për caktimin e njëjësive zbatuese për hatimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020”;
- Akt Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”;
- Ligj nr. 97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”;
- VKM Nr. 905, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”;
- VKM nr. 5, datë 6.1.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”;
- VKM nr. 6, datë 6.1.2020 “Për kushtet, kriteret dhe procedurat për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike”;
- Vendim nr. 6, datë 16.12.2019 “Për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga tërmeti i datës 26 nëntor”;
- Vendim nr.878, datë 24.12.2019 “Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit”;
- Akt normativ nr. 6, datë 30.11.2019 “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”;

- Ligj nr. 80/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 6, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”;
- Akt normativ nr. 8, datë 7.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”;
- Ligj nr. 96/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 16.12.2019, të Këshillit të ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”;
- VKM nr. 7, datë 6.1.2020 “Për kushtet dhe procedurën për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”;

KONTROLLI DHE DISIPINIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

- Ligj Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar;
- Ligj Nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;
- VKM Nr. 312, datë 5.5.2010 “Për miratimin e Rregullores "Për Sigurinë në Kantier”
- VKM Nr. 447, datë 19.09.1994 “Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit;
- VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektete veprave të ndërtimit”;
- VKM nr.679, datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore”;
- VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, e ndryshuar;
- VKM Nr.58, datë 1.2.2006 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit për çimentot, për të cilat ka rëndësi parësore rezistenca dhe qëndrueshmëria”;
- VKM Nr.279, datë 18.4.2007 “Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit”, ndryshuar
- Udhëzim i KM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar;
- Udhëzim i KM Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”;

LEGJISLACIONI: BANESAT SOCIALE

- Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;
- VKM Nr. 361, datë 29.5.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”;

- VKM Nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”;
- VKM Nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”;
- VKM Nr. 454, datë 3.7.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”;
- VKM Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin” ;
- VKM Nr.148, datë 13.2.2008 “Për përcaktimin e procedurave për blerjen e banesave, me kosto të ulët, në treg”;
- VKM Nr.198, datë 4.5.1993 (Azhornuar me VKM nr.40 datë 26.01.2001, VKM-në nr.724 datë 05.11.2004, VKM-në nr.810 datë 16.11.2016 dhe VKM-në nr.14 datë 12.01.2018) “Për krijimin e entit kombëtar të banesave”;
- VKM Nr.456, datë 16.4.2008 “Për procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve, që përfitojnë banesa me kosto të ulët”;
- VKM Nr. 814, datë 3.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”;
- VKM Nr. 405, datë 1.6.2016 “Për miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016–2025”;
- VKM Nr. 87, datë 3.2.2016 “Për miratimin e dokumentit politik të përfshirjes sociale 2016–2020”;
- Udhëzim Nr.19, datë 13.09.2007 (Ndryshuar me Udhëzimin nr.3, datë 25.04.2016) “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”.


FONDI PYJOR- KONVERTIMI

- Ligj Nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e procedurave të zvogëlimit të sipërfaqës të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”;
- Udhëzim nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”.

Shtojcë: Zona Arkeologjike “A” dhe “B” e qytetit të Durrësit

Zona Arkeologjike “A” dhe “B” e qytetit të Durrësit është miratuar me Vendim Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e Zonave Arkeologjike A dhe B të qytetit të Durrësit dhe të Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”.

Zona Arkeologjike “A” dhe “B” e qytetit të Durrësit

**MIRATOHET:**

KRYEMINISTRI
Edi RAMA

MINISTRIA E KULTURËS
Ministër
Mirela KUMBARO FURXHI

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
Drejtor
Arta Dollani

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK
Drejtor
Rudina ZOTO

Legjenda:

■ Zona arkeologjike “A”
■ Zona arkeologjike “B”

Vendim Nr. ___, Datë __/__/2018

Plani për “Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit” përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse, për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, si dhe përcaktimin e kufijve të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore

Bazuar në Pikën 3 të Nenit 2 të këtij Plani: “Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Durrësit merr në konsideratë kufijtë e zonifikimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B, të qytetit të Durrësit, si dhe planin për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”.

Në zonën Arkeologjike “A”, të qytetit të Durrësit, lejohet vetëm:

- mirëmbajtja, restaurimi dhe konservimi i integruar i monumenteve të kulturës dhe strukturave arkeologjike, pas shqyrtimit dhe miratimit të projekteve nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në vijim KKTKM;
- kryerja e formave të testimit, të tilla si: sondazhe që nuk cenojnë shtresat arkeologjike, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, të përcaktuara me vendim të KKTKM-së;
- zbatimi i projekteve kërkimore shkencore të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKTKM-ja;
- rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;
- rikonstruksioni/rindërtimi i godinave ekzistuese pa ndryshim të gjurmës, volumi i përgjithshëm i të cilave nuk cënon pasuritë kulturore të nëntokës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga KKTKM-ja;

dh) vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 1 kat, në funksion të informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, trashëgiminë kulturore si dhe nevojave të tjera të rikualifikimit urban të zonës, si më poshtë:

i. konstruksionet duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin.

ii. projekti për vendosjen e konstruksioneve të lehta miratohet nga KKTKM-ja dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen dhe vendndodhjen e strukturës.

iii. vendosja e tyre duhet të bëhet nën mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore të specializuara.

2. Projektet lidhur me ndërhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A”, të qytetit të Durrësit, të parashikuara në shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja, dhe vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në zonën arkeologjike “B”, të qytetit të Durrësit, përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe ndërtimet e reja pas miratimit nga KKTKM-ja. Projektet për ndërtimet e reja shqyrtohen dhe miratohen nga KKTKM-ja, dhe vijojnë procedurën sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Ndërtimet e reja lejohen vetëm pas kryerjes të formave të testimit të përcaktuara nga KKTKMja, në varësi të potencialit arkeologjik që përfaqëson zona. Gërmimi arkeologjik kryhet sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike

1. Për ndërhyrjet e lejuara në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit, projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 80, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Për çdo rast, KKTKM-ja shqyrton dhe vendos për kryerjen ose jo të formave të testimit. Testimet kryhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe/ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë. Shpenzimet për kryerjen e formave të testimit mbulohen nga investitori.

3. Testimet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, kryhen sipas përcaktimeve të KKTKM-së, pas lidhjes së aktmarrëveshjeve përkatëse, ku në çdo rast njëra nga palët nënshkruese është Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në vijim IKTK.

4. Për ndërhyrjet e parashikuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 3, përpara zbatimit të tyre, me miratim të KKTKM-së, nga subjekte të licencuara ose institucionet e specializuara shtetërore realizohen: a) format e testimit sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 3, të mbikëqyrura nga institucionet shtetërore të specializuara; b) monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara.

5. Për të gjitha ndërhyrjet në zonat arkeologjike realizohet monitorim arkeologjik gjatë zbatimit të punimeve nga subjekte të licencuara dhe/ose institucione shtetërore të specializuara dhe mbikëqyrje arkeologjike nga institucionet e specializuara shtetërore.

AMFITEATRI DURRËS

Objekti i Amfiteatrit të Durësit është monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 886, datë 10.06.1973.



Ortofoto Amfiteatri, Durrës

Është ndërtuar në dekadat e para të shekullit të II , ndoshta në kohën e sundimit të perandorit romak Hadrianit. Në ndryshim me amfiteatro të tjerë të kohës, të ndërtuar tërësisht në terren të rrafshët, ai mbështetet pjesërisht në një shpat kodre, duke shfrytëzuar terrenin përmbështetjen në një rënë anë të shkallares, ndërsa pjesa tjetër lartësohet në terren të sheshtë me një fasadë të përpunuar nga ana tektonike, që shihet nga pjesa kryesore e qytetit. Përmasat e boshteve të planimetrisë eliptike 132,4 m. x 113,2 m. me një arenë në qendër prej 61,4 x 42,2m. dhe lartësi që arrinte në 20 m..

Ambiente që shërbenin për qëndrimin e kafshëve në të cilat zbriteshin me anë galerish të pajisura me shkallë, ruhen në pjesën verilindore të shkallares së zbuluar nga gërmimet arkeologjike. Pas xokolit shtrihet rrugina e parë (precinctio) me gjerësi 2,5 m. e cila shërben për kalimin e spektatorëve që mbushnin katër radhët e para të shkallares. Pas këtyre radhëve ndodhet një tjetër rrugë mbi të cilën hapen daljet (vomitorium) nga galeritë e brendëshme që furnizojnë menjanën e parë të shkallares (cavea). Cavea përshkohet nën të prej galerish të mbuluara me qemer, të përforcuara me nervatura të gjera dhe të larta ,për të siguruar një qëndrueshmëri më të madhe. Galeritë perimetrale ndodhen në nivelin e rrugicave të kalimit të spektatorëve dhe komunikojnë me to duke siguruar hyrjen dhe daljen e shpejtë të numurit të madh spektatorëve .

Fuqia ekonomike e Dyrrahut në periudhë romake mishërohet në përmasat e mëdha të amfiteatrit si dhe në aftësinë inxhinerike të ndërtuesëve të tij

Amfiteatri është zbuluar në vitin 1966 nga arkeologu i njohur Vangjel Toçi dhe është shpallur monument kulture në vitin 1973. Ai është i ndërtuar në fillim të shek.II p.e.s dhe është një nga amfiteatrot më të mëdhenj të botës antike. Deri tani është zbuluar më pak se gjysma e monumentit, ku përbëhet nga shkallarja, galeritë dhe menianumet.

Është ndërtuar me muraturë të përzier me tulla edhe gurë. Mendohet që kapaciteti i spektatorëve ka qënë mbi 18000 vetë. Këtu realizoheshin ndeshje mes gladiatorësh dhe aktivitete të ndryshme. Pas braktisjes u kthye në varrezë dhe u ndërtua kisha në shek. V.




Foto Amfiteatri, Durrës

Pas tërmetit të datës 26.11.2019, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe specialistët e DRTK Tiranë, kanë bërë inspektimin e monumentit. Në bazë të inspektimit, objekti në vetvete ka dëmtime të lehta, por dëmtimet më të medha i kanë ardhur nga ndërhyrjet e jashtme, sic janë ndërtimet e pozicionuara sipër monumentit.



Gjurma e objekteve që propozohen për ritrajtim

KALAJA DURRËS

Objekti “Kalaja e Durrësit” është monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 586/4874, datë 17.03.1948 / 23.09.1971.


Gjatë historisë, Durrësi ka qenë një nga qytetet port më të rëndësishme të fortifikuara në Shqipëri dhe në botën antike dhe bizantine. Kalaja ka vlera të konsiderueshme arkitektonike dhe historike, pasi ajo përbën një përzierje shumë të pasur të teknikave të ndryshme të ndërtimit dhe periudhave historike (të lashta, bizantine, mesjetë).





Ortofoto Kalaja Durrës dhe Muret Rrethuese

Kalaja e Durrësit është kështjellë e mesjetës së hershme dhe ndodhet në skajin jugperëndimor të gadishullit të Durrësit. Sot nga muret e vona antike të Durrësit ruhet një trakt me katër kulla, në anën jugperëndimore, një traktë i shkëputur nga muri juglindor, paralel me bregun e detit, dhe fare pak gjurmë në rrafsh me tokën, prej murit që kthente nga veriperëndimi dhe atij në drejtim të veriut.



Muri jug- perëndimorë për aq sa ruhet sot, ai ka një gjatësi të rujtur 490 m. Në përgjithësi muri ruhet deri në nivelin e shtegut të kalimit që ndodhet mesatarisht 9 m nga tabani, ndërsa trashësia e tij është 3.5 m, muri është ndërtuar krejtësisht prej tullash të lidhura me shtresa të trasha llaçi. Themelet janë ndërtuar me gurë. Në vendet e pjerrta ato ndjekin terrenin në formë të shkallëzura dhe janë 15 cm më të gjëra se muri. Pjesa e sipërme e konstruksioneve të vjetra të murit është mjaft e rrënuar. Mbi të ruhen kryesisht vetëm bedena me frengji që i përkasin periudhës mesjetare. Muri juglindor ruhet në

pak gjurmë. Një trakt 24 m i gjatë dhe 2.5 m i lartë ndodhet 80 m në lindje të kullës “A”. Muri mund të ndiqet më tej në formë gjurmësh të izoluar të rrafshuara me tokën, prapa ish bankës së shtetit, ku ai kthen në drejtim të veriperëndimit. “Pas ish shkollës 8-vjeçare 16 Shtatori”. Traktet e mësipërme janë ndërtuar me të njëjtën teknikë me murin jugperëndimorë. Përjashtim bën vetëm trakti pranë ish Shtëpisë së pionerit (aktualisht Qendra Kulturore e Fëmijëve Durrës), ku dallohen substrukcione me një teknik pak më të ndryshme. Këto substrukcione ndodhen në skajin perëndimor të këtij trakti, përbëhen nga një fragment qemeri porte dhe një pjesë muri mbi të që vazhdon dhe në drejtim të lindjes.



Foto e realizuar në objekt para tërmetit

Pas tërmetit të datës 26.11.2019, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe specialistët e DRTK Tiranë, kanë bërë inspektimin e monumentit, i cili rezulton në gjëndje tepër të dëmtuar.

Kulla e hershme Bizantine, e ndërtuar fillimisht nga Anastasi (490-518), e identifikuar si Kulla C, ka pësuar një kolaps të madh që rezulton në gjysmën e strukturës origjinale të rrëzuar në tokë. Blloqe masive të muraturave janë shkatërruar dhe kanë rënë.


Struktura e mbetur në këmbë e kullës dhe mureve të Kalasë në përgjithësi, ka pësuar dëme të mëdha të cilat mund të vërehen përmes pranisë së çarjeve të thella të gjata dhe anësore.



Foto e realizuar në objekt pas tërmetit

TERMAT ANTIKE TE PALLATI I KULTURËS

Është zbuluar në Durrës në vitin 1960. Gjatë ndërtimit të pallatit të kulturës “Aleksander Moisiu ” ka marrë statusin monument kulture në vitin 1973. Përmisimi i jetës publike në qytetet Romake, solli në përhapjen e praktikave higjienike dhe të ndërtimeve përkatëse si banjot private dhe ato publike. Këto banjo i atribuohen fazës së rëndësishme urbanistike të gjysmës së parë të shek. II p.e.s. Këto banjo ishin të pajisura me tepidarium, frigidarium, pishina. Aktualisht janë të dukshme dy ambiente. Në perëndim të këtij kompleksi kalon rruga e vetme Romake e gjetur në drejtimin veri-jug.



Ortofoto Termat Antike Durrës



ROTONDA

Pazari i vjetër është zbuluar në vitet 1987-1990 dhe është shpallur monument kulture në vitin 2003. U zbulua nga Afrim Hoti ku dolën në dritë rrënojat e një shesh-tregu të periudhës bizantine. Mendohet që monumenti të jetë ndërtuar në shek. II p.e.s deri në shek.IV dhe të ketë funksionuar si i tillë deri në shek. VII. Më vonë ky Pazar është kthyer në varreza. Monumenti është kompozuar në formën e një portiku rrethor, në mesin e të cilit gjendet një podium. Monumenti ka sherbyer si shesh publik ku organizoheshin panairret.





HAMAMI NË OBORRIN E SHKOLLËS "16 SHTATORI"

Objekti "Hamami në oborrin e Shkollës "16 Shtatori" me vendndodhje në Durrës është monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.

Hamami ndodhet në qendër të qytetit, është ndërtuar në shek.XVIII dhe ka marrë statusin monument kulture në vitin 1973. Pjesa qendrore e objektit është realizuar me kupolë ndërsa pjesa tjetër që është më e ulët është realizuar me harqe guri. Ndriçimi është realizuar nëpërmjet hapësirave të vogla me kupolë me përmasa 15x15cm. Ngrohja e ambjenteve bëhej nëpërmjet kazanëve të bakrit, ku avulli qarkullonte nëpërmjet tubave prej qeramike.



Ortofoto Hamami Mesjetar, Durrës

Pjesa qendrore e objektit është realizuar me kupolë ndërsa pjesa tjetër që është më e ulët është realizuar me harqe guri. Ndryshimi është realizuar nëpërmjet hapësirave të vogla me kupolë me përmasa 15x15cm. Ngrohja e ambienteve bëhet nëpërmjet kazanëve të bakrit, ku avulli qarkullonte nëpërmjet tubave prej qeramike.



Foto Hamami Mesjetar, Durrës

Pas tërmetit të datës 26.11.2019, specialistët e DRTK Tiranë kanë bërë inspektimin e monumentit, në të cilin rezultojnë të ketë pësuar dëmtime mesatare në objekt. Dëmtime të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, për tu mos u thelluar më tej.

BANESA E "A MOISIU"- MUZEU ETNOGRAFIK, DURRËS

Objekti "Banesa e "A Moisiu"- Muzeu Etnografik "me vendndodhje në Durrës është monument kulture kategoria e I-rë, shpallur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës Nr. 1886, datë 10.06.1973.



Ortofoto Muzeu Etnografik, Durrës

Banesa Aleksandër Moisiu është ndërtuar në shek. XIX nga një familje tregëtare. Në këtë banesë ka kaluar një pjesë të jetës “Aleksander Mosiu”. Në fillim të shek. XX është kthyer në banesë strehimi deri në vitin 1980 të këtij shekulli. Ajo është një banesë dy katëshe me çardak. Çatia me tjegulla vendi, dysHEME dhe tavane me dërrasa. Fasada e punuar me gurë të skuadruar, shkallët e realizuara me blloqe guri. Ka sterrë për grumbullimin e ujrave që vijnë nga çatia. Kangjellat e shkallëve janë punuar në mënyrë artizanale.



Foto e realizuar në objekt para tërmetit

Pas tërmetit të datës 26.11.2019, specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, DRTK Tiranë dhe Specialistët e Misionit Italian në Shqipëri “Grupi Task Force MiBACT-U4H”, kanë bërë inspektimin e monumentit, i cili rezulton në gjëndjë mjaft të dëmtuar.



Foto e realizuar në objekt pas tërmetit

Objekti ka dëmtime në muraturën dhe në tjegullat e çatisë. Rënia e suvasë është e dukshme si nga jashtë, ashtu edhe brënda objektit. Gjithashtu në këtë objekt fondi i ekspozuar është në risk për shkak të kushteve delicate të ndërtesës. Ai ka pësuar dëmtime si krisje të vetrinave ekspozuese.



Foto e realizuar në objekt pas tërmetit



Foto e realizuar në objekt pas tërmetit

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁶

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

⁶ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Aktin Normativ nr.9, datë16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Përgjegjës ka shkelur Aktin Normativ gjatë procedurës së prokurimit publik për rindërtimin, atëherë keni të drejtë të ankoheni siç parashikohet në nenin 42 të Aktit Normativ nr.9/2019.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 18

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

* * *

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. _____
 Emri i plotë i shoqërisë _____
 Etj. _____
 numri i NIPT-it _____

* * *

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazën tjetër të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
 Emri i plotë i shoqërisë _____
 Vlera _____
 (me numra dhe fjalë) _____
 numri i NUIS-it _____

2. _____
 Emri i plotë i shoqërisë _____
 Vlera _____
 (me numra dhe fjalë) _____
 Etj. _____
 numri i NUIS-it _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. _____
 Emri i plotë i shoqërisë _____
 numri i NUIS-it _____
 2. _____
 Emri i plotë i shoqërisë _____
 numri i NUIS-it _____
 Etj. _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra].

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 19

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Përgjegjës në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____/ Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____/ Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit përgjegjës dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit përgjegjës]

Shtojca 20

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjandë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Përgjegjës” do të thotë Autoriteti Përgjegjës që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjti me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit për Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Përgjegjës duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

7.5 Gjatë zbatimit të kontratës, kontraktuesi duhet të koordinojë me kontraktorët e tjerë zbatues në vendodhjen e shërbimeve sipas metodës që do të propozojë me qëllim ecurine dhe zbatimin brenda afatit të kontratës.

7.6 Kontraktori duhet të paraqesë planin e koordinimit tek drejtuesi i projektit për shqyrtim dhe miratin e tij.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

